



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"

Bordi i Administrimit

Nr. 1237 Prot

Shkodër, më 29 . 03 2025

VENDIM

Nr. 109 , datë 25 . 03 2025

Për përcaktimin e kodit dhe gjuhës në të cilën do të zhvillohet programi i studimit i ciklit të dytë, Master i Shkencave në "Sigurim i cilësisë së ushqimit dhe të ushqyerit", ofruar nga Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Departamenti i Biologji – Kimisë, USH, për vitin akademik 2025- 2026, aplikuar për hapje pranë MAS"

Bazuar në ligjin Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 3, pika 2, gërma b; neni 35, pika 1; neni 38. pika 1, gërma "dh"; neni 80; Vendimi nr. 310, datë 11. 05. 2022 "Për specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", pika 8; Udhëzimin e MAS nr. 2, datë 21. 01. 2025 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr. 1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", i ndryshuar, pika 3 e Kreut IV/A, gërma a); në Statutin e Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi" neni 17, pika 6, gërma f); Vendimi i Senati Akademik të USH-së nr. 261, datë 21. 11. 2024 "Për miratimin e disa programeve të studimit për vitin akademik 2025-2026"; Shkresën e Fakultetit të Shkencave të Natyrës nr. 315 prot., datë 25. 03. 2025 "Kodifikim i programit të studimit", me vendim të Senati Akademik nr.101 të datës 25. 03. 2025;Bordi i administrimit me vendim qarkullues të datës 25.03.2025 me shumicë votash

VENDOSI:

1. Miratimin e kodit dhe gjuhës në të cilën do të zhvillohet programi i studimit, në kuadër të aplikimit për hapjen e programit të studimit të ciklit të dytë, Master i Shkencave në "Sigurim i Cilësisë së Ushqimit dhe të Ushqyerit", ofruar nga Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Departamenti i Biologji – Kimisë, USH, për vitin akademik 2025- 2026, sipas materialit bashkëngjitur këtij vendimi.

2. Gjuha në të cilën do të zhvillohet ky program studimi do jetë **“Gjuha Shqipe” (S)**; Kodi i programit të studimit është **72MS0521S**.

3. Ky vendim të ngarkohet në portalin e- Albania, për miratim të mëtejshëm nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari i Bordit të Administrimit

Prof. Asoc.Dr. Adnan EKA



FAKULTETI SHKENCAVE TE NATYRES

UNIVERSITETI "LUIGJ GURAKUQI"

FAKULTETI FAKULTETI SHKENCAVE TE NATYRES

DEPARTAMENTI BIOLOGJI KIMI

Emërtimi i Programit të studimit	Master i Shkencave "Sigurimi i Cilësisë së Ushqimit dhe të Ushqyerit"
Niveli i programit të studimit sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimit	Niveli 7
Kohëzgjatja e programit të studimit	2 vite akademike
Lloji i programit të studimit	Cikli i dytë Master i Shkencave
Fusha e detajuar ku bën pjesë programi i studimit	0521
Gjuha e programit të studimit	Gjuha shqipe
Propozimi i njësisë bazë dhe argumentimi lidhur me kodet që duhet të përmbajë programi i studimit	Kodi i këtij programi studimi është përcaktuar sipas Vendimit nr.310, datë 11.05.2022
Kodi i programit të studimit	72MS0521S

